



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:144277

Datë: 01.02.2024

Numri i dokumentit: 05272025

PPP.nr.823/21

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Leart Rexhaj, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Sejdiu, në çështjen përmbartimore të kreditorit KUR “M.” sh.a, rr. L, S – M, kundër debitorit Rr.R nga M, për borxh në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar nga librat afarist, sipas urdhrimit për lejimin e propozimit përmbartimor të përmbartuesit privat A.M, me seli në M P.nr.695/2021 i dt. 26.04.2021, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, jashtë seancës gjyqësore, me datën 29.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET prapësimi i ushtruar në emër të debitorit si i bazuar, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.695/2021 i dt. 26.04.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat A.M, me seli në M si dhe abrogohen të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarra në këtë procedurë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Kreditori, KUR “M.”, me seli në M, më datën 26.04.2021, ka parashtruar propozim për përmbartim, ndaj debitorit Rr.R nga M, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afarist, duke kërkuar që në emër të borxhit, debitori t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,841.62 euro, me kamatë prej 8% nga dita e arritshmërisë për pagesë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shumën e shpenzimeve të procedurës përmbartimore, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh.

Përmbaruesi privat A.M, me seli në M, me urdhër përmbarues P.nr.695/2021 i dt. 26.04.2021, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbarimore.

Ndaj urdhrin përmbarimor, me datën 31.05.2021 ka ushtruar prapësim Sh.R, e cila ka njoftuar gjykatën se debitori ka ndërruar jetë dhe si provë ka bashkangjitur certifikatën e vdekjes.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke kërkuar që prapësimi i ushtruar nga debitori të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata, pas shiqimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, e në vecanti certifikatën e vdekjes me numër të referencës 11/2005/RV/11001 të dt. 26.05.2021 për personin Rr.R këtu debitor, erdhi në një përfundim se duhet të aprovohet prapësimi si i bazuar, të anulohet urdhri përmbarimor, pasi që sikur propozimi për përmbarim, e rrjedhimisht edhe urdhri për përmbarim janë të palejueshëm nga faktet si në vijim:

Me nenin 2 paragrafi 1 pika 1.6 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, është paraparë se *“Palë - kreditori apo debitori në procedurën përmbaruese”*. Neni 17 i LPP-së ka paraparë se *“Në procedurën përmbarimore përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po që se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*.

Neni 73 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka paraparë se *“Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik”*. Me nenin 76 të LPK-së, është paraparë se *“Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën me pazotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor, dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë, kur ai është i nevojshëm”*, ndërsa në paragrafin 4 të të njëjtit nen theksohet se *“Po që se të metat e treguara nuk mund të mënjanohen, apo në qoftë se afati i caktuar nga gjykata kalon pa sukses, gjykata me aktvendim i abrogon veprimet e kryera po që se janë përfshirë me të metat në fjalë dhe do ta hedhë poshtë padinë, po që se të metat kanë natyrë të tillë që pengojnë procedimin e mëtutjeshëm të çështjes”*.

Nisur nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se kemi të bëjmë një urdhër të lejuar nga Përmbaruesi Privat ndaj një personi i cili nuk mund të paraqitet si palë në procedurë, kjo nisur nga fakti që debitori në këtë çështje përmbarimore ka vdekur para se të dorëzohet propozimi për përmbarim ndaj tij, fakt ky i provuar nga certifikata e vdekjes, me numër të referencës 11/2005/RV/11001 të dt. 26.05.2021, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Mitrovicë.

Nga arsyet e lartcekura, gjykata vendosi që ta aprovoj prapësimin si të bazuar, ta anuloj urdhrin për përmbarim P.nr.695/2021 i dt. 26.04.2021, si të palejueshëm, pasi që procedura nuk mund të fillohet, zhvillohet dhe përfundoj ndaj një personi i cili nuk është në jetë, pasi që legjislacioni ka paraparë situatën e marrjes se të drejtave dhe detyrimeve nga ana e pasardhësve me rastin e vdekjes se një personi, e të cilat situata janë formale në kuptim të zhvillimit të procedurës gjyqësore.

Pasi që procedura nuk mund të iniciohet kundër personit të vdekur, i cili në momentin e vdekjes ka humbur zotësinë juridike për të qenë palë në procedurë, gjykata konform nenit 78. par.4 të LPK-së e ka anuluar urdhrin përmbartimor dhe të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë procedurë, duke gjetur se kjo mungesë është e asaj natyre e cila e ndalon udhëheqjen e mëtejme në këtë çështje përmbartimore.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi konform nenit 13 të LPP -së, lidhur me nenin 450 të LPK -së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.823/2021 me datën 29.01.2024

Gjyqtari,
Leart Rexhaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.